



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 20, Datë 20.01.2021

MBI

**LËNIEN NË FUQI TË VENDIMIT TË BORDIT TË ERE NR. 122, DATË 29.07.2019
“MBI MIRATIMIN E DRAFT KONTRATËS NDËRMJET KESH SH.A DHE OSSH
SH.A, PËR SHIT-BLERJEN E SASISË SË TEPËRT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, QË
REZULTON PAS PËRMBUSHJES SË KËRKESËS SË KLIENTËVE QË PËRFITOJNË
NGA SHËRBIMI UNIVERSAL ME QËLLIM MBULIMIN E HUMBJEVE NË RRJETIN
E SHPËRNDARJES PËR PERIUdhËN KOHORE 01.01.2019 – 31.12.2019”**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 20, gërma “h” të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshur; nenit 5, pika 4 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 244, datë 30.03.2016, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licensuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, i ndryshuar dhe nenit 15 dhe 26 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), nr.96, datë 17.06.2016, bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 20.01.2021, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 13/4 prot, datë 19.01.2021 të përgatitur nga Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve,

Konstatoi se:

- ERE me vendimin e bordit nr. 122, datë 29.07.2019, vendosi miratimin e Kontratës ndërmjet Korporatës Elektroenergjitike Shqiptare (KESH sh.a) dhe Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH sh.a), për shit-bletjen e sasisë së tepërt të energjisë elektrike, që rezulton pas përmbushjes së kërkesës së klienteve që përfitojnë nga shërbimi universal me qëllim mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për periudhën kohore 01.01.2019 – 31.12.2019, sipas detyrimeve ligjore në fuqi.
- KESH sh.a dhe OSSH sh.a nuk kanë negociuar dhe dakordësuar ende një Draft-Kontratë të re për shit-bletjen e sasisë së tepërt të energjisë elektrike, që rezulton pas përmbushjes së kërkesës së klientëve që përfitojnë nga shërbimi universal me qëllim mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për vitin 2021, e cila do të duhet të miratohet nga ERE.
- Në të njëjtën kohë nuk rezulton të jenë konstatuar kontestime nga palët në lidhje me zbatimin e Kontratës ndërmjet “KESH” sh.a dhe “OSSH” sh.a, për shit-bletjen e sasisë së tepërt të energjisë elektrike, që rezulton pas përmbushjes së kërkesës së klienteve që

përfitojnë nga shërbimi universal me qëllim mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për periudhën kohore 01.01.2019 – 31.12.2019.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Lënien në fuqi të vendimit të Bordit të ERE nr. 122, datë 29.07.2019 “Mbi miratimin e draft kontratës ndërmjet KESH sh.a dhe OSSH sh.a, për shit-blerjen e sasisë së tepërt të energjisë elektrike, që rezulton pas përmbushjes së kërkesës së klientëve që përfitojnë nga shërbimi universal me qëllim mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për periudhën kohore 01.01.2019 – 31.12.2019”, deri në paraqitjen e draft kontratës së re nga KESH sh.a dhe OSSH sh.a dhe miratimin e saj nga ERE.
2. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve, të njoftojë palët KESH sh.a dhe OSSH sh.a mbi vendimin e bordit të ERE.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet që nga data 01.01.2021.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare